

Universiteti i Elbasanit mori pjesë në Konferencën Kombëtare organizuar nga AKKSHI dhe MAS

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mori pjesë në Konferencën Kombëtare me temë "Bashkëpunimi Universitet-Biznes, një nga shtyllat e modernizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", organizuar nga AKKSHI dhe MAS.

Universiteti i Elbasanit, është fitues i disa projekteve të financuara nga AKKSHI dhe në këtë konferencë u prezantua në panelin e diskutimit nga zëvendësrektorja e universitetit, Prof.as.dr. Elvira Fetahu me një projekt kërkimor-shkencor.

